



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

# Propozicionet e Garave për 3x3

22.02.2022, Prishtinë

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

## **Kreu I – DISPOZITAT THEMELORE**

### **Neni 1 – Qëllimi i Propozicioneve të Garave**

Propozicionet e Garave (në tekstin e mëtejshëm Propozicionet) rregullojnë zhvillimin dhe rrjedhën e garave të 3x3 që organizohen ose mbikëqyren nga Federata e Basketbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm FBK).

### **Neni 2 – Organizatorët e Garave**

Turneu Final dhe Turneu Selektiv në 3x3 organizohen nga FBK. Turnetë tjerë mund të organizohen nga promotorë privatë, klube, shkolla dhe shoqata, derisa i plotësojnë kriteret e FBK-së, të përcaktuara me Rregulloren e Garave të 3x3 dhe këto Propozicione.

### **Neni 3 – Menaxhimi i Garave**

Menaxhimin e Garave në 3x3 e bën Koordinatorin i FBK-së për 3x3. Koordinatorin i FBK-së për 3x3 është edhe autoriteti për interpretimin e këtyre Propozicioneve. Në rast të ankesës në vendimet e Koordinatorit, autoritetet shqyrtues si shkallë e dytë dhe përfundimtar është Bordi i FBK-së.

### **Neni 4 – Informimi Publik**

Koordinatorin i FBK-së për 3x3 për vendimet e tij dhe për zhvillimet tjera të rëndësishme (datat e turneve, oraret, renditjen finale, garat e përfaqësueses etj) informon zyrën e FBK-së, që obligohet këto lajme ti publikojë në uebfaqen zyrtare të FBK-së dhe faqet zyrtare në rrjete sociale.

## **KREU II – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Neni 5 – Rregullat e lojës**

Në të gjitha garat e 3x3 që administrohen ose mbikëqyren nga FBK, vlejnë Rregullat e Lojës të miratuara nga FIBA.

### **Neni 6 – Topi zyrtar**

Topi duhet të jetë i rrumbullakët. Sipërfaqja e jashtme duhet të jetë prej lëkure, gome ose plastike.

Topi zyrtar i garës është madhësia 6 (perimetri i tij nuk duhet të jetë më i vogël se 72,4 cm dhe më shumë se 73,7 cm) dhe pesha midis 567 dhe 650 g - top special 3x3.

Topi duhet të jetë i fryrë me ajër në shtypje të mjaftueshme që kur lëshohet nga një lartësi prej 1,80 m (180 cm), e matur nga pjesa e poshtme, kërcen në një lartësi midis 1,20 m (120 cm) dhe 1,40 m (140 cm), e matur në majë të saj.

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviç  
10 000 Prishtina

Në turnetë e kategorisë A dhe B Turneun Final ose Turneun Selektiv, është i detyrueshëm përdorimi i topit zyrtar për 3x3 që sigurohet nga organizatorët. Në nivelin tjerë të garave (turnetë e kategorive të reja, turnetë rekreative, të veteranëve etj) mund të zhvillohen edhe me top të madhësisë 7.

### **Neni 7 – Fusha e lojës**

Për turnetë e kategorisë A dhe Turneun Selektiv përdoret fusha zyrtare e lojës, me sipërfaqe të aprovuar nga FIBA dhe me dimensione 11m x 15m. Në raste tjera mund të përdoret gjysma e fushës normale të basketbollit (14m x 15m), ose fushë tjetër e lojës, me gjatësi minimale 9 metra.

Asnjë pengesë ose barrierë nuk mund të qëndrojë në largësi prej 1m nga vijat anësore dhe fundore të fushës.

Lartësia e tavanit ose e pengesës më të ulët mbi fushën e lojës duhet të jetë së paku 5 metra. Ndriçimi i fushës duhet të jetë i njëtrajtshëm në të gjithë sipërfaqen e saj dhe nuk mund të pengojë zhvillimin e ndeshjes ose të shpërqendrojë lojtarët.

### **Neni 8 – Kohëzgjatja e ndeshjeve dhe turneve**

Të gjitha ndeshjet e kategorisë së seniorëve, zhvillohen sipas rregullave të FIBA-s. Për ndeshjet e kategorive të reja, organizatori ka të drejtë të zhvillojë ndeshjet në kohëzgjatje tjetër, nëse për këtë paraprakisht informon FBK-në dhe pjesëmarrësit në turne.

### **Neni 9 – Kalendar i Garave**

Kalendar i Garave miratohet dhe përditësohet nga Koordinator i FBK-së për 3x3, i cili obligohet të informojë Bordin e FBK-së dhe Komesarin e Garave të FBK-së.

### **Neni 10 – Orari i ndeshjeve**

Orari i garave përcaktohet një ditë para garës, në bazë të renditjes së skuadrave. Ekipet radhiten në grupe sipas sistemit serpentin, kurse radhitja e bartësve të grupeve bëhet sipas kriterëve të FIBA-s.

### **Neni 11 – E drejta e garimit**

Në turnetë e 3x3, që monitorohen dhe administrohen nga FBK, të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë lojtarët që kanë profil të konfirmuar nga platformat zyrtare të FIBA-s. Afatet dhe procedurat për lajmërimin e ekipeve dhe lojtarëve, vendosen para secilit turne dhe administrohen nga promotorët dhe Koordinator i FBK-së për 3x3.

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

### **Neni 12 – Lajmërimi i ekipeve**

Më së voni 1 ditë para çdo turneu të 3x3, të gjitha aplikacionet e nevojshme duhet të plotësohen dhe dorëzohen, përfshi këtu dhe tarifën e regjistrimit të paguar, në rast se aplikohet një tarifë e tillë.

Nëse ekipi nuk dorëzon aplikimin online dhe dokumentacionin ose aplikimin ose dokumentacionin e nevojshëm nuk është i plotë ose nuk siguron shlyerjen në kohë të detyrimeve financiare, nuk ka të drejtë të garimit në turne.

### **Neni 13 – Sistemi i garave**

Një ditë para fillimit të turneut, promotori obligohet të informojë Koordinatorin e FBK-së për 3x3 për të gjithë pjesëmarrësit në turne dhe detajet sportive e organizative të turneut (numri i kategorive garuese, numri i fushave, numri i ekipeve).

Koordinatori i FBK-së për 3x3, në bazë të informatave nga promotori mbikëqyr radhitjen e ekipeve në grupe dhe sistemin e garave në secilin turne.

Koordinatori i FBK-së për 3x3 obligohet që para turneut, të lajmërohen të gjithë pjesëmarrësit, zyrtarët dhe mediat për orarin dhe sistemin e garave.

### **Neni 14 – Deklarata e përgjegjësisë individuale**

Secili lojtar pjesëmarrës në turnetë që administrohen dhe mbikëqyren nga FBK është i obliguar të nënshkruajë Deklaratën e Përgjegjësisë Individuale, që përpilohet nga Koordinatorin i FBK-së për 3x3.

## **KREU III**

### **Neni 15 – Ekipet pjesëmarrëse**

15.1 FBK nuk ka ndalesa ose kufizime rreth emërtimeve të ekipeve. Si parim ekipet mund të marrin emrat:

- \* e qyteteve/fshatrave të Kosovës – nëse shumica e lojtarëve në një ekipi vijnë nga ai qytet/fshat
- \* klubeve ekzistuese të basketbollit – nëse shumica e lojtarëve janë të regjistruar në klubin në fjalë
- \* emërtimet e dikurshme ose të lashta të vendbanimeve (psh Ulpiana, Vicianum, Dardania etj)
- \* Emrat e sponsorëve

15.2 FBK lejon edhe emra të tjera, me kusht që nuk manifestojnë vulgaritet, ofendime, racizëm ose nuk shkaktojnë provokim të ndonjë grupi shoqëror. Në ato raste, Koordinatorin i FBK-së për 3x3, ka të drejtë të refuzojë aplikacionin e ekipit për pjesëmarrje në gara dhe të udhëzojë ndryshimin e emrit garues, në afat prej 24 orësh.

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

15.3 Në rast të ndryshimit të përbërjeve të ekipit, ose transferimit të lojtarëve, emrin e ekipit nga sezoni i kaluar ka të drejtë ta mbajë përbërja që në radhë të veta ia ka dy lojtarët më të mirë, sipas rang-listës së FIBA-s.

### **Neni 16 – Përbërja e ekipit**

Në secilin turne marrin pjesë ekipet që duhet të kenë jo më pak se tre dhe jo më shumë se katër lojtarë, tre nga të cilët duhet të kenë shtetësi të Kosovës.

Drejtuesi i ekipit konfirmon përbërjen të paktën 30 minuta para fillimit të ndeshjes së parë të ekipit të tij tek personi përgjegjës për regjistrimin e ekipeve të konkurrencës një listë të lojtarëve dhe zyrtarëve të ekipit.

Në rast se ekipi nuk lajmëron një Drejtues, komunikimin zyrtar e kryen kapiteni i ekipit.

Për të pasur të drejtë paraqitjeje në turnetë e Kategorisë A e B, Turneun Selektiv, Turneun Përfundimtar, lojtarët duhet të kenë profile zyrtare në platformën përkatëse të FIBA-s.

Lojtarët pjesëmarrës në turne që administrohen dhe mbikëqyren nga FBK, pajisen edhe me numër rendor dhe licencë të FBK-së.

Në hapësirën për ekipe në fushën e lojës, mund të qëndrojnë vetëm lojtari rezervist. Drejtuesi i ekipit, trajneri, ose persona zyrtarë të tjerë, nëse janë të paraqitur në listën zyrtare, mund të qëndrojnë jashtë rrethojave të fushës.

### **KREU IV – Gjyqtarët dhe gjyqtarët ndihmës**

#### **Neni 17 – Lista e Gjyqtarëve**

Lista e gjyqtarëve për 3x3 miratohet nga Bordi i FBK-së, me propozim të Komesarit të Garave të FBK-së. Komesari i Garave delegon gjyqtarët për turnetë e 3x3.

Ndeshjet e të gjitha turneve zyrtare të grup moshës së seniorëve dhe veteranëve gjykohen nga dy gjyqtarë. Ndeshjet e kategorive të reja, në rrethana të caktuara mund të gjykohen nga një gjyqtar.

#### **Neni 18 – Gjykimi**

Gjyqtarët i gjykojnë ndeshjet në bazë të rregullave të lojës 3x3 dhe këtyre propozicioneve. Gjyqtarët janë të pavarur në vendimet e tyre. Gjyqtarët janë përgjegjës për zbatimin e rregullave dhe rendit në fushën e lojës dhe janë të obliguar të bashkëpunojnë në mënyrë korrekte me organizatorët e turneut dhe ndihmës-gjyqtarët.

Gjyqtarët përdorin uniforma dhe pajisje sportive, që lejohen me rregullat e lojës, të miratuara nga FIBA.

Gjyqtari i parë mund të pezullojë ndeshjen në rast të sjelljeve jo sportive nga

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

lojtarët, personat zyrtarë ose shikuesit. Gjyqtari mund ta pezullojë ndeshjen, nëse shikuesit:

- \* fyejnë lojtarët, gjyqtarët ose ndihmës gjyqtarët, me brohoritje josportive, fyese, vulgare, shoviniste ose raciste,
- \* hyjnë në fushë dhe provokojë një zënkë, ose tentojnë të sulmojnë lojtarët ose gjyqtarët,
- \* hedhin sende të ndryshme dhe shkaktojnë rrezik të lëndimit të lojtarëve ose gjyqtarëve,
- \* vazhdojnë të hedhin objekte të buta ose të forta në fushë pavarësisht paralajmërimit,
- \* vazhdojnë të përdorin mjete piroteknike pavarësisht paralajmërimit,
- \* hedhin lëndë piroteknike në këndin e lojërave ose mes spektatorëve.

I njëjti vendim mund të merret nga arbitri në rast të sjelljes josportive të lojtarëve ose drejtuesit të ekipit.

Gjyqtari i parë vendos nëse ndeshja e pezulluar do të vazhdojë apo do të ndërpritet.

### **Neni 19 – Ankesat**

Në rast të një anese të ekipit në pas ndeshjes, gjyqtari i parë është i detyruar të bëjë një deklaratë me shkrim. Ankesat trajtohen nga Koordinatori i FBK-së për 3x3 dhe Komesari i Garave.

### **Neni 20 – Protokollin dhe dokumentet e turneut**

Pas përfundimit të secilës ndeshje, gjyqtari i parë nënshkruan protokollin e ndeshjes dhe pranimin e ndonjë anese, ose raporti për shkelje disiplinore. Gjyqtari i Parë është përgjegjës edhe për dorëzimin e dokumentacionit të turneut tek Koordinatori i FBK-së për 3x3.

### **Neni 21 – Shkeljet disiplinore**

Raportet për shkelje disiplinore raportohen tek Koordinatori i FBK-së për 3x3 menjëherë pas përfundimit të turneut. Koordinatori i FBK-së për 3x3 mund të kërkojë raporte dhe deklarata shtesë, kurse vendimet për shkelje disiplinore i sjell në bazë të dispozitave të këtyre propozicioneve dhe Rregullores së Garave për 3x3.

Gabimet ose shkeljet e gjyqtarëve ose ndihmës gjyqtarëve, sanksionohen nga Komesari i Garave.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

## Neni 22 – Tarifat dhe mëditjet

Lista e kostove për tarifat, mëditjet dhe shpenzimet e udhëtimit për gjyqtarët miratohet nga Bordi i FBK-së.

## Neni 23 – Gjyqtarët ndihmës

Gjyqtarë ndihmës konsiderohen matësi i kohës, mbajtësi i kohës së sulmit dhe mbajtësi i protokollit.

Emrat e gjyqtarëve ndihmës për turnetë e 3x3 i miraton Komesari i Garave. Promotorët udhëzohen që në gara të angazhojnë gjyqtarët ndihmës që posedojnë licenca të FBK-së edhe për ligat tjera të basketbollit. Delegimin e gjyqtarëve ndihmës, e bën Komesari i Garave.

Gjyqtarët ndihmës përdorin pajisjet e lejuara nga FIBA dhe të siguruar nga FBK, promotori, ose organizatori i turneut.

## KREU V – RRJEDHA E NDESHJES

### Neni 24 – Dispozitat në fuqi

Organizatori i turneut obligohet që të organizojë turneun në pajtueshmëri me aktet normative të FBK-së dhe rregullat e lojës, të miratuara nga FIBA.

### Neni 25 – Procedura para fillimit të ndeshjes

Procedura para ndeshjes zbatohet si më poshtë:

5 minuta para fillimit të ndeshjes, gjyqtarët janë të detyruar të shtrëngojnë duart me lojtarët dhe ndihmës gjyqtarët dhe të kryejnë inspektimi i pajisjeve teknike dhe ndihmës gjyqtarëve.

2 minuta para fillimit të ndeshjes, skuadrat shtrëngojnë duart me ftesë të arbitrit të parë. Në rast prezantimeve zyrtare, fillimisht prezantohet ekipi i parë në protokoll (skuadrën vendase) pastaj ekipi i dytë në protokoll (mysafir) dhe në fund gjyqtarët.

60 sekonda para fillimit të ndeshjes, gjyqtari i parë thërret dhe i drejton lojtarët në anash, nga një lojtar nga çdo ekip, për të bërë hedhjen e monedhës për posedimin e parë të topit.

20 sekonda para fillimit të ndeshjes, gjyqtari i parë do të thërrasë dhe do të shoqërojë tre lojtarë nga çdo ekip në fushë. Ata do të fillojnë ndeshjen.

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

## KREU VI – MASAT DISIPLINORE

### Neni 26 – Shkeljet e Propozicioneve

Shkelësit e dispozitave të Propozicioneve, sanksionohen nga Koordinatorin i FBK-së për 3x3, sipas dispozitave disiplinore, të cilat i bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtyre propozicioneve.

### Neni 27 – Gabimet Teknike

Lojtarit që gjykohet me Gabim Teknik ose me Gabim Diskualifikues ndëshkohet sipas dispozitave disiplinore të këtyre propozicioneve.

Gabimi teknik edhe për lojtarin rezervë, i shkruhet ekipit.

Në rast se lojtari në defansivë ndëshkohet me GT – 1 gjuajtje e lirë për ekipin kundërshtar dhe posedimi i topit (ora e sulmit kthehet në 12 sekonda).

Në rast se lojtari në ofensivë ndëshkohet me GT – 1 gjuajtje e lirë për kundërshtarin, loja vazhdon me posedim dhe me kohë të sulmit të pandryshuar.

Dënimi për një GT ekzekutohet menjëherë (shembull: mund të jetë edhe ndërmjet dy gjuajtjeve të lira

për shkak të një gabimi personal në gjuajtje nëse GT jepej midis dy gjuajtjeve të lira). Nuk ka GT në rast se lojtarët kërcejnë për posedim (jump ball).

### Neni 28 – Gabimet Diskualifikuese

Lojtarët që përjashtohen – diskualifikohen nga një ndeshje, mund të përjashtohen deri në fund të turneut.

Drejtuesi i skuadrës që përjashtohet nga ndeshja ose ndaj tij ka vërejtje nga gjyqtarët, në vazhdim të turneut. ai mund të mos marrë më pjesë aktive. Në këtë rast, rolin e drejtuesit të ekipit e merr një nga lojtarët e ekipit. Në rast të mosrespektimit të vendimeve, skuadra mund të përjashtohet nga turneu.

Vendimi i gjyqtarit të parë, në raste të përjashtimeve nga turneu, është definitiv.

### Neni 29 – Gabimi i dyfishtë jospportiv

Një lojtar që përjashtohet për shkak të dy gabimeve personale jo sportive, nuk i nënshtrohet pezullimit automatik. Lojtari mund të luajë në ndeshjen e ardhshme

### Neni 30 – përsëritja e shkeljeve

Si parim, shkeljet e përsëritura, sanksionohen me dyfishim të dënimit, varësisht nga shkelja.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

### **Neni 31 – Loja pasive/zvarritja e ndeshjes**

Çdo ekipi mund ti gjykohet vetëm një paralajmërim në ndeshje për shkak të zvarritjes së lojës (delay call) – psh (loja aktive në mbrojtje brenda gjysmërrethit pas arritjes së koshit, rikthim gabuar e topit, vonesa me fillimin e posedimit të topit pas koshit të marrë, goditje e qëllimshme e topit pas koshit të arritur, pritja e gabuar e topit "të nxehtë").

### **Neni 32 – Procedurat e ankesës**

Ankesa bëhet sipas procedurës së përshkruar më poshtë. Ndryshe, konsiderohet se nuk është depozituar siç duhet.

- a) Menjëherë pas përfundimit të kohës së lojës në kohën e rregullt ose shtesë, përpara se të nënshkruhet procesverbali nga gjyqtarët, kapiteni i ekipit që ankues duhet të nënshkruajë procesverbalin në hapësirën me titull "Nënshkrimi i ekipit në protestë". Në fund të procesverbalit ai duhet të përshkruajë shkurt arsyet e protestës.
- b) Një garanci prej 50.00 euro duhet të paguhet në përputhje me Rregullat Zyrtare 3x3 në çdo protestë, nëse jo, është ankesa nuk shqyrtohet.

### **Neni 33 – Vendimi për ankesa**

Ankesat për vendime të gjyqtarëve i shqyrton Komesari i Garave dhe për procedurat dhe afatet e shqyrtimit, vlejné në mënyrë analoge dispozitat e Propozicioneve të Garave të FBK-së për ligat e seniorëve.

Dispozitat e lartcekura, vlejné në mënyrë analoge edhe për këto propozicione, edhe për rastet e gabimeve eventuale materiale të gjyqtarëve ose gabimeve në ndeshje të plejofit.

Ankesat për vendime në rast të lëshimeve organizative, shqyrtohen nga Koordinatori i FBK-së për 3x3.

### **Neni 34 – Klasifikimi i ekipeve**

34.1 Për klasifikim përfundimtar të ekipeve, përdoren statistikat dhe të dhënat e sistemit të FIBA-s. Si parim, në një turne përdoren kriteret e mëposhtme:

- a) numri i fitoreve
- b) rezultati në ndeshjet e ndërsjella
- c) mesatarja e pikëve të shënuara

34.2 Në rast se dy ekipe kanë numër të njëjtë të fitoreve, atëherë vendimtar për klasifikim është rezultati i duelit të ndërsjellë.

Në rast se tri ekipe kanë numër të barabartë të pikëve, atëherë përdoren kriteret e mëposhtme:

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 48 703 333  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

- numri i fitoreve në ndeshje të ndërsjella
- mesatarja e pikëve të shënuara në të gjitha ndeshjet në turne
- kumulativi i pikëve të tre lojtarëve më të mirë të ekipit në rang-listën e FIBA-s, një ditë para fillimit të turneut
- shorti

## KREU VII – Dispozitat kalimtare e përfundimtare

### Neni 35 – Aktet tjera normative

Për të gjitha rastet që nuk parashihen në këto propozicione vlejné dispozitat e Rregullores së Garave për 3x3, Rregullat e Lojës të miratuara nga FIBA dhe në mënyrë analoge vlejné edhe Propozicionet e Garave dhe Rregullorja e Garave e FBK-së për ligat seniore.

### Neni 36 – Ndëshkimet

Për shkeljet disiplinore në turnetë e 3x3 vlejné dispozitat e rregullave të FIBA-s. Aty ku është e domosdoshme, aplikohen ndëshkimet me shkeljet analoge si në Ligën e Parë të Kosovës.

### Neni 37 – Interpretimi

Interpretimin e Propozicioneve të Garave e bën Koordinatori i FBK-së për 3x3.

Leart Hoxha  
Koordinator i FBK-së për 3x3

Arben Fetahu

Federata e Basketbollit të Kosovës



Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:

